



MINISTRIA E TURIZMIT,
KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

KODI GLOBAL
I ETIKES NE TURIZEM



TIRANË 2006



MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

KODI GLOBAL I ETIKËS NË TURIZËM

Tiranë 2006

PARATHËNIE

Në kuadrin e politikave prioritare të Qeverisë, ku një vend të rëndësishëm zë dhe zbatimi i parimit të qëndrueshmërisë në të gjitha nivelet, si dhe në kuadër të koordinimit të politikave kombëtare me ato ndërkombëtare, dokumenti i Kodit Global të Etikës, përgatitur nga Organizata Botërore e Turizmit, vendos një kuadër referimi për një zhvillim të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm të sektorit të turizmit.

Kodi Global i Etikës për Turizmin, është kërkuar si domosdoshmëri në Rezolutën e Mbledhjes së Ansamblesë së Përgjithëshme të Organizatës Botërore të Turizmit në Stamboll 1997 dhe tashmë është shpërndarë në më shumë se 70 vende antare të OBT.


Kodi përfshin nëntë nene, të cilat nënvizojnë “rregullat e lojës” për destinacionet, qeveritë, tour-operatorët, agjentët turistikë, punonjësit dhe vetë udhëtuesit, ndërsa neni i dhjetë i tij përfshin rregullimin e ankesave apo vërejtjeve kur një kod i tillë do të fillojë të ketë mekanizmat e tij detyrues. Kjo bazohet në rregullimin nëpërmjet krijimit të një Komiteti Botëror mbi Etikën në Turizëm, i cili do të ketë përfaqësues nga çdo rajon i botës dhe përfaqësues nga çdo grup aktiv i sektorit turistik.

Në kuadrin e Planit të Veprimit të Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit Kulturor dhe Natyror, Kodi është dokument i nevojshëm për të ndihmuar minimizimin e impaktit negativ të turizmit mbi ambientin dhe trashëgiminë kulturore si dhe për maksimizimin e përfitimeve të rezidentëve të destinacionit turistik.

Prezantimi i këtij Kodi, synon përfshirjen e opinioneve dhe veprimeve konkrete të Institucioneve dhe grupeve të tjera të interesuara të sektorit të turizmit në drejtim të rregullimit të marrëdhënieve dhe sigurimit të një zhvillimi të qëndrueshëm të tij.

Bujar LESKAJ

MINISTRI



PARIMET

Kodi përfshin **9 nene** të cilët përcaktojnë “rregullat e lojës” për destinacionet, qeveritë, tur-operatorët, zhvilluesit, agjentët e udhëtimit, punonjësit dhe vetë udhëtarët. **Neni i 10-të** përfshin zgjidhjen e pakënaqësive dhe shënon herën e parë që një kod i këtij tipi të ketë mekanizma detyrues.

Neni 1

Kontributi i turizmit në respektin dhe mirëkuptimin reciprok ndërmjet popujve dhe shoqërive.

Neni 2

Turizmi si një mjet për plotësim individual dhe kolektiv.

Neni 3

Turizmi, një faktor për zhvillimin e qëndrueshëm.

Neni 4

Turizmi, përdorues i trashëgimisë kulturore të njerëzimit dhe kontribues në përmirësimin e saj.

Neni 5

Turizmi, një aktivitet i dobishëm për vendet dhe komunitetet pritëse.

Neni 6

Detyrimet e faktorëve në zhvillimin e turizmit.

Neni 7

E drejta për turizëm.

Neni 8

Liria e lëvizjes në turizëm.

Neni 9

Të drejtat e punonjësve dhe sipërmarrësve në industrinë e turizmit.

Neni 10

Zbatimi i parimeve të Kodit Global të Etikës për Turizmin.

NENI I

Kontributi i turizmit në mirëkuptimin dhe respektin reciprok ndërmjet popujve dhe shoqërive.

1. Mirëkuptimi dhe promovimi i vlerave të përbashkëta etike të njerëzimit me një qëndrim tolerance dhe respekti për diversitetin në besimin fetar, filozofik dhe atë moral, janë të dyja themeli dhe pasoja e turizmit të përgjegjshëm; faktorët në zhvillimin e turizmit dhe vetë turistët duhet të vëzhgojnë dhe të njohin vlerat e traditave dhe praktikave social – kulturore të të gjithë popujve, duke përfshirë edhe ato të minoriteteve dhe popujve indigjene.
2. Aktivitetet e turizmit duhet të zhvillohen në harmoni me atributet dhe traditat e rajoneve dhe vendeve pritëse si dhe në respekt me legjislacionin, zakonet dhe praktikatat përkatëse.
3. Komunitetet pritëse në njërin anë dhe profesionistët lokalë në anën tjetër, duhet të njohin dhe respektojnë turistët si dhe të informohen rreth stilit të tyre të jetës, shijeve dhe atë ç'ka presin; edukimi dhe trajnimi i paanshëm i profesionistëve kontribuon në një mikpritje të ngrohtë.

4. Është detyrë e autoriteteve publike t'i sigurojnë mbrojtje turistëve dhe vizitorëve si dhe sendeve të tyre personale; ata duhet t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë kujdesit për turistët të cilët mund të kenë një vulnerabilitet të veçantë; ata duhet të lehtësojnë prezantimin e mjeteve specifike të informacionit, parandalimit, sigurisë, siguracioneve dhe asistencës në përputhje me nevojat e tyre; çdo sulm, agresion, rrëmbim, apo kërcënim kundrejt turistëve apo profesionistëve në industrinë e turizmit, si dhe shkatërrimi me dashje i faciliteteve të turizmit apo elementeve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, duhet të dënohen rreptësisht dhe ndëshkohen në zbatim të ligjeve respektive.

5. Gjatë udhëtimit turistët apo vizitorët nuk duhet të kryejnë ndonjë akt kriminal apo ndonjë akt të konsideruar kriminal nga legjislacioni i vendit të vizituar dhe duhet të shmangin çdo sjellje e cila mund të perceptohet si ofenduese apo dëmtuese nga popullsia lokale, apo mund të sjellë dëmtimin e ambientit lokal; ata duhet të shmangen nga trafikimi i barnave të ndaluara, armëve, antikave, specieve të mbrojtura, produkteve dhe substancave që janë të rrezikshme apo të ndaluara nga rregullat vendase.

6. Turistët dhe vizitorët duhet të kenë pëergjegjësinë e informimit të vetvetes me karakteristikat e vendeve të cilët po përgatiten të vizitojnë, para nisjes për udhëtim; ata duhet të jenë të kujdesshëm lidhur me risqet shëndetësore të pranishme në çdo udhëtim jashtë ambientit të zakonshëm të jetesës dhe të kujdesen të minimizojnë këto risqe.

NENI 2

Turizmi si një mjet për plotësimin individual dhe kolektiv.

1. Turizmi, aktivitet që në të shumtën e rasteve është i lidhur me pushimin dhe shplodhjen, sportin dhe aksesin në kulturë dhe natyrë, duhet të planifikohet dhe praktikohet si një mjet i privilegjuar i plotësimit individual dhe kolektiv; kur praktikohet pa paragjykime, është një faktor i pazëvendësueshëm i vetëdukimit, tolerancës reciproke dhe mjet për të mësuar rreth ndryshimeve dhe diversitetit legjitim ndërmjet popujve dhe kulturave.

2. Aktivitetet e turizmit duhet të respektojnë barazinë ndërmjet burrave dhe grave, ato duhet të promovojnë të drejtat e njeriut dhe në mënyrë më të veçantë të drejtat e grupeve vulnerabël, fëmijëve, të moshuarve, njerëzve me aftësi të kufizuara, minoriteteve etnike dhe popujve indigjene.

3. Shfrytëzimi i qenieve njerëzore në çdo formë, në mënyrë të veçantë shfrytëzimi seksual, sidomos kur aplikohet tek fëmijët, konfliktin me qëllimet thelbësore të turizmit dhe është mohim i tij; si të tilla në akordancë me legjislacionin ndërkombëtar, duhet të luftohen energjistikisht duke bashkëpunuar të gjithë shtetet e interesuara dhe të penalizohet pa kushte nga legjislacioni i të dy vendeve të vizituara dhe vendeve të cilët kryejnë këto akte, madje edhe kur ato zhvillohen jashtë kufijve.

4. Udhëtimi për qëllim besimi fetar, shëndeti, edukimi dhe shkëmbimi kulturor apo linguistik janë në mënyrë të veçantë forma të dobishme të turizmit të cilat meritojnë inkurajim.

5. Duhet të inkurajohet përfshirja në curricula i vlerave të shkëmbimeve turistike, atyre ekonomike, benefiteve social-kulturore si dhe risqet e tyre.

NENI 3

Turizmi një faktor i zhvillimit të qëndrueshëm.

1. Të gjithë faktorët në zhvillimin e turizmit duhet të ruajnë mjedisin natyror me synimin e arritjes së një rritje ekonomike të sigurt, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme, në varësi kjo të plotësimit në mënyrë të paaneshme të nevojave dhe aspiratat e të sotmes dhe brezave të ardhshëm;

2. Duhet të jenë prioritet dhe të inkurajohen nga autoritetet publike lokale dhe rajonale të gjitha format e zhvillimit të turizmit, të cilat çojnë në kursimin e burimeve të çmuara dhe të rralla, në mënyrë të veçantë të ujit dhe energjisë, gjithashtu në shmangien e sa të jetë e mundur të prodhimit të mbeturinave.

3. Kombinimi në kohë dhe hapësirë i fluksit të turistëve, në mënyrë të veçantë e atyre që rezultojnë në periudhën e pushimeve të paguara apo pushimeve të shkollës, dhe për më shumë shpërndarja e pushimeve duhet të shikohen në mënyrë të tillë që të reduktohet

trysnia e aktivitetit të turizmit në mjedis dhe të rritet impakti i dobishëm në industrinë e turizmit dhe ekonominë lokale.

4. Infrastruktura turistike duhet të përvijohet dhe aktivitetet turistike duhet të programohen në mënyrë të tillë që të mbrohet trashëgimia natyrore e përbërë nga ekosistemet dhe biodiversiteti si dhe të mbrohen gjallesat e egra të cilat janë në rrezik; faktorët në zhvillimin e turizmit dhe në mënyrë të veçantë profesionistët, duhet të bien dakord në vendosjen e limiteve apo detyrimeve mbi aktivitetin e tyre, kur ato ushtrohen në zona të veçanta të ndjeshme si: shkretëtirë, rajone polare ose malore, zona bregdetare, pyje tropikale apo laguna, të favorshëm për krijimin e rezervave natyrore apo zonave të mbrojtura.

5. Turizmi i natyror dhe ekoturizmi njihen si ekzistenca të favorshme për rritjen dhe pasurimin e pozitës së turizmit, duke siguruar respekt për trashëgiminë natyrore dhe popullsinë vendase dhe duke harmonizuar kapacitetet mbajtëse të rajoneve.

NENI 4

Turizmi, një përdorues i trashëgimisë kulturore të njerëzimit dhe kontribues në përmirësimin e saj.

1. Burimet e turizmit i përkasin trashëgimisë të përbashkët të njerëzimit; komunitetet në territoret e të cilave janë të vendosura këto trashëgimi kanë të drejta dhe detyrime të veçanta mbi to.

2. Aktivitetet dhe politikat turistike duhet të zhvillohen duke respektuar trashëgiminë artistike, arkeologjike dhe kulturore të cilat duhet të mbrohen edhe për brezat e të ardhmes; në mënyrë të veçantë duhet t'i kushtohet kujdes ruajtjes dhe restaurimit të monumenteve, vendeve të kultit dhe muzeumeve, si dhe zonave arkeologjike apo historike të cilat duhet të jenë të hapura për vizitorët; duhet të inkurajohen vizitat e publikut në monumentet kulturore pronë private, duke respektuar të drejtat e pronarëve, gjithashtu vizitat në objektet fetare pa paragjykuar nevojat normale të ushtrimit të fesë.

3. Burimet financiare të cilat rrjedhin nga vizita e monumenteve dhe zonave kulturore duhet, ose të paktën një pjesë e tyre, të përdoren për ruajtjen, sigurinë, zhvillimin dhe përmirësimin e kësaj trashëgimie.

4. Aktiviteti turistik duhet të planifikohet në mënyrë të tillë që të lejojë produktet tradicionale kulturore, zëjet dhe folklorin të mbijetojnë dhe lulëzojnë, pa shkaktuar degjenerimin dhe standartizimin e tyre.

NENI 5

Turizmi, një aktivitet i dobishëm për vendet dhe komunitet pritëse.

1. Popullsia lokale duhet të jetë e lidhur me aktivitetet e turizmit dhe pjesë në përfitimin ekonomik, social dhe

kulturor dhe në mënyrë të veçantë në krijimin e vendeve të reja direkte dhe indirekte të punës.

2. Politikat turistike duhet të aplikohen në mënyrë të tillë që të ndihmojnë rritjen e standarteve të jetës për popullsinë e rajoneve të vizituara si dhe të ndihmojnë plotësimin e nevojave të tyre; planifikimi dhe zgjidhjet arkitekturore si dhe operimi i risorteve turistike duhet të kenë si qëllim integrimin e tyre sa me shumë që të jetë e mundur me strukturën ekonomike dhe sociale lokale; kur aftësitë janë të barabarta, prioritet i duhet dhënë fuqisë punëtore vendase.

3. Një kujdes i veçantë i duhet kushtuar problemeve specifike të zonave bregdetare dhe territoreve të ishujve si dhe rajoneve të ndjeshme malore dhe rurale për të cilat shpesh turizmi përfaqëson një mundësi të veçantë për zhvillim, përballë rënies të aktiviteteve ekonomike tradicionale.

4. Profesionistët në turizëm në mënyrë të veçantë investitorët, të udhëhequr nga rregullat e vendosura nga autoritetet lokale publike, duhet të zhvillojnë studime për impaktin e projekteve të tyre në mjedis; ata duhet të informojnë me transparencën dhe objektivitetin më të madh lidhur me programet apo tërheqjet e parashikuara për të ardhmen dhe të nxisin dialogun me popullsinë e interesuar.

NENI 6

Detyrimet e faktorëve në zhvillimin e turizmit

1. Profesionistët në turizëm kanë detyrim të informojnë turistët me objektivitet dhe ndershmëri lidhur me destinacionet dhe kushtet e udhëtimit, mikpritjen dhe qëndrimin; ata duhet të sigurojnë se kontratat e propozuara klientëve të tyre janë lehtësisht të kuptueshme për nga natyra, çmimi dhe cilësia e shërbimit; ata anagazhohen për një kompensim financiar të pagueshëm prej tyre në rastin e ndonjë prishje të njëanshme të kontratës nga ana e tyre.
2. Profesionistët në turizëm, për aq sa varet prej tyre, duhet të tregojnë interes për bashkëpunimin me autoritetet lokale publike lidhur me mbrojtjen, sigurinë, parandalimin e aksidenteve, mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë e ushqimit ndaj atyre të cilëve u ofrojnë shërbimin; gjithashtu, ata duhet të sigurojnë ekzistencën e një sistemi të pranueshëm siguracionesh dhe asistence; ata duhet të pranojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin lokal dhe të paguajnë një kompensim të drejtë në rast të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale.
3. Profesionistët në turizëm, për aq sa varet prej tyre, duhet të kontribuojnë në plotësimin shpirtëror dhe kulturor të turistëve dhe t'u lejojnë që gjatë udhëtimit të praktikojnë besimin e tyre fetar.
4. Autoritetet publike të vendeve gjenerues dhe të vendeve pritës, në bashkëpunim me profesionistët dhe

shoqatat e tyre, duhet të sigurojnë mekanizmat e nevojshëm për riatdhesimin e turistëve në rastin e ndonjë falimentimi të shoqërisë e cila ka organizuar udhëtimin e tyre.

5. Qeveritë kanë të drejtat dhe detyrimet, në mënyrë të veçantë në raste krizash, të informojnë nënshtetasit për rrethanat e vështira, ose për rreziqet që ata mund të hasin gjatë udhëtimit të tyre jashtë vendit; është në përgjegjësinë e tyre t'i sigurojnë një informacion të tillë të pandikuar nga paragjykimet, apo sjellje të ekzagjeruara, të pajustificuara, për industrinë e turizmit të vendeve mikpritëse dhe interesave të operatorëve vendas; përmbajtja e këshilluesve të udhëtimit duhet të jetë diskutuar paraprakisht me autoritetet e vendeve pritëse dhe profesionistët e interesuar; rekomandimet e formuluar duhet të jenë në proporcion të drejtë me rëndësinë e situatës të evidentuar dhe i kufizuar në zonën gjeografike në të cilën kjo situatë është prezente; këshillues të tillë duhet të përmirësohen ose anulohen sapo vendosen kushtet e normalitetit.
6. Shtypi, në mënyrë të veçantë shtypi i specializuar për udhëtimet, apo ndonjë media tjetër, përfshirë këtu mjetet moderne të komunikimit elektronik, duhet të paraqesin një informacion të ndershëm dhe të balancuar për ngjarjet dhe situatat të cilat mund të ndikojnë në fluksin e turistëve; ata gjithashtu duhet të sigurojnë një informacion të kujdesshëm dhe të besueshëm për konsumatorët e shërbimeve në turizëm; komunikimi i ri dhe teknologjitë moderne elektronike duhet të zhvillohen dhe përdoren për këtë qëllim; në asnjë rast media nuk duhet të promovojë seks - turizmin.

NENI 7

E drejta per turizëm

1. Perspektiva e të drejtës personale dhe direkte për të zbuluar dhe shijuar burimet e planetit, përbën një të drejtë të barabartë për të gjithë banorët e botës; pjesmarrja gjithnjë e më shumë në turizmin ndërkombëtar dhe kombëtar duhet të shikohet si një nga mundësitë më të mira të shprehjes të rritjes së qëndrueshme të kohës së lirë dhe nuk duhet të ketë pengesa në këtë rrugë.

2. E drejta universale për turizëm duhet të shikohet si konkluzion i të drejtës për shpłodhje dhe pushim, duke përfshirë pakësimin në mënyrë të arsyeshme të kohës së punës dhe pushimet periodike të paguara, të garantuara nga Neni 24 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe nenit 7 të Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike Sociale, dhe Kulture.

3. Turizmi social dhe në mënyrë të veçantë turizmi i shoqëruar, i cili lehtëson shtrirjen e të drejtës për shpłodhje, udhëtim dhe pushim, duhet të zhvillohet me mbështetjen e autoriteteve publike.

4. Duhet të inkurajohet dhe krijohen lehtësi për turizmin e familjeve, të rinjve, studentëve, turistëve të moshuar si dhe për njerëzit me aftësi të kufizuara.

NENI 8

Liria e lëvizjes në turizëm

1. Në zbatim të legjislacionit ndërkombëtar dhe lokal, turistët dhe vizitorët duhet të përfitojnë nga e drejta për lëvizje brenda vendeve të tyre ose nga një shtet në tjetrin, në përputhje me nenin 13 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; ata duhet të kenë akses në vendet e tranzitit apo qëndrimit si dhe në zonat kulturore pa qenë subjekt i formaliteteve diskriminuese apo të ekzagjeruara.

2. Turistët dhe vizitorët, duhet të kenë akses në të gjitha format e vlefshme të komunikimit, të brendshëm apo të jashtëm; ata duhet të përfitojnë nga një shërbim i shpejtë i administratës lokale, shërbimeve shëndetësore dhe ligjore; ata duhet të jenë të lirë për të kontaktuar me shërbimin konsullor të vendeve të tyre të origjinës në përputhje me procedurat diplomatike në fuqi.

3. Turistët dhe vizitorët duhet të përfitojnë të njëjtat të drejta si të qytetarëve në vendet që po vizitojnë lidhur me konfidencialitetin e të dhënave personale dhe informacionit që ka të bëjë me to, në mënyrë të veçantë kur ato janë të ruajtura elektronikisht.

4. Procedurat administrative që kanë të bëjnë me kalimin e kufirit edhe kur ato janë kompetencë e vetë shteteve apo rezultat i marrëveshjeve ndërkombëtare, siç janë lëshimi i vizave ose formalitetet e sigurimit të shëndetit apo shërbimit doganor, duhet të përshtaten sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë që të

lehtësohet në maksimum liria e lëvizjes dhe përhapja e turizmit ndërkombëtar; duhet të inkurajohen marrëveshjet ndërmjet grup vendesh të cilat harmonizojnë dhe thjeshtojnë këto procedura; duhet të pakësohen apo korrektohen gradualisht taksat specifike apo pagesat të cilat penalizojnë industrinë e turizmit dhe minojnë konkurrencën e këtij sektori.

5. Për aq sa e lejon situata ekonomike e vendeve nga të cilët vijnë, turistët duhet të kenë lehtësi financiare në monedhë të konvertueshme për udhëtimet e tyre.

NENI 9

Të drejtat e punonjësve dhe sipërmarrësve në industrinë e turizmit

1. Të drejtat themelore të punonjësve me pagesë dhe të vetë-punësuarve në sektorin e turizmit dhe aktivitetet e lidhura me të, duhet të jenë të garantuara nën supervizionin e administratës lokale dhe kombëtare si nga shtetet e origjinës dhe vendet pritëse, me kujdesin e duhur që rrjedh nga detyrime specifike të cilat janë të lidhura në mënyrë të veçantë me aspektin sezonal të veprimtarisë, dimensionin global të kësaj industrie dhe fleksibilitetin shpesh të kërkuar prej tyre për shkak të natyrës së këtij aktiviteti.

2. Punonjësit e paguar dhe të vetë-punësuarit në industrinë e turizmit dhe aktivitetet e lidhura me të, kanë të drejtën dhe detyrimin të përfitojnë trajnim fillestar të përshtatshëm dhe të vazhdueshëm; atyre duhet t'u sigurohet një mbrojtje e përshtatshme; sa më

shumë që të jetë e mundur duhet të limitohet puna e pasigurt; për punonjësit sezonalë të sektorit duhet të ofrohet një status specifik duke i kushtuar një vëmendje të veçantë mirëqenies sociale të tyre.

3. Çdo individ apo person juridik i cili gëzon aftësitë e nevojshme, duhet të lejohet të zhvillojë aktivitetet profesionale në fushën e turizmit në zbatim të legjislacionit vendas; sipërmarrësit dhe investitorët sidomos në ndërmarrjet të mesme dhe të vogla duhet të lejohen të kenë akses të lirë në sektorin e turizmit me një minimum detyrimesh administrative apo ligjore.

4. Shkëmbimi i eksperiencës i ofruar nga vende të ndryshme, qeveritareve apo punonjësve, të paguar ose jo, kontribuon në edukimin e zhvillimit të botës së industrisë së turizmit; këto lëvizje duhet të lehtësohen sa më shumë që të jetë mundur në përputhje me ligjet kombëtare të aplikuara dhe konventat ndërkombëtare.

5. Si një faktor i pazëvendësueshëm i solidaritetit në zhvillimin dhe rritjen dinamike të shkëmbimeve ndërkombëtare, kompanitë multinacionale të industrisë së turizmit duhet të mos përdorin pozicionet dominuese që disa herë okupojnë; ata duhet të shmangin imponimin artificial të mjeteve të modeleve sociale – kulturore në vendet dhe komunitetet pritëse; në këmbim të lirisë së tyre për të investuar dhe tregtuar e cila duhet të jetë e padiskutueshme, ata duhet të përfshijnë vetvehten në zhvillimet lokale duke shmangur riatdhesimin jashtë mase të përfitimeve të tyre apo importeve të detyruara, si pakësim i kontributit të tyre në ekonominë në të cilat ata janë ngritur.

6. Partneriteti dhe vendosja e marrëdhënieve të balancuara ndërmjet kompanive të vendeve të origjinës dhe atyre pritëse, kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe në shpërndarjen e paanëshme të përfitimeve nga rritja e këtij zhvillimi.

NENI 10

Implementimi i parimeve të Kodit Global të Etikës në Turizëm

1. Faktorët publikë dhe privatë në zhvillimin e turizmit duhet të bashkëpunojnë në implementimin e këtyre parimeve dhe të monitorojnë aplikimin e tyre efektiv.

2. Faktorët në zhvillimin e turizmit duhet të njohin dhe pranojnë rolin e institucioneve ndërkombëtare, ndërmjet të cilave Organizata Botërore e Turizmit radhitet e para dhe organizatave jo qeveritare të specializuara në fushën e promovimit dhe zhvillimit të turizmit, mbrojtjes së të drejtave të njeriut, shëndetit dhe mjedisit, me respektin e duhur për parimet e përgjithshme të legjislacionit ndërkombëtar.

3. Vetë faktorët e zhvillimit të turizmit duhet të demonstrojnë synimin e tyre për t'ju referuar në rastin e ndonjë mosmarrëveshje, aplikimit apo interpretimit të Kodit Global të Etikës në Turizëm duke ju drejtuar një strukturë të paanshme të njohur si Komiteti Botëror i Etikës në Turizëm.